



K.DH.SH.II.nr.1037/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.T.Sh “Dino” Sh.P.K me seli në fshatin Konjuh – Lipjan, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokat Naser Gashi nga Lipjani, kundër të paditurit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim i aktit administrativ, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1860/18, të datës 14.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.10.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit N.T.Sh “Dino” Sh.P.K me seli në fshatin Konjuh – Lipjan, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1860/18, i datës 14.10.2021, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me Aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës së shkallës së parë është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit N.T.Sh “Dino” Sh.P.K me seli në fshatin Konjuh – Lipjan me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi i të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) i Republikës së Kosovës me numër K.A.nr.051/2018 i datës 19.06.2018, si e pa bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit për procedurën kontestimore, Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të ligjit material, me propozim që të aprovoj këtë ankesë kurse Aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1860/18, i datës 14.10.2021 ta ndryshoj në favor të paditësit duke e aprovuar kërkesëpadinë ose këtë aktgjykim ta prish dhe lëndën ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar pala e paditur me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa e paditësit dhe të vërtetohet Aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1860/18, i datës 14.10.2021.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar në drejtim të thënieve në ankesë, përgjigjes në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës në kuptim të nenit 44, par. 1 dhe 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjen se:

Ankesa është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me Aktvendimin nr.051/2018, me datë 19.06.2018, është refuzuar ankesa me nr.3481 të datës 04.05.2018 të parashtruar nga ndërmarrja NTSH “Dino” Sh.P.K me pronar A.S. me nr. biznesit 70080965 me adresë Konjuh KK-Lipjan. Mbetet i plotëfuqishëm vendimi me nr.1169/a datë 23.04.2018 në shumën prej 43,963.60€ për aktivitet ilegal pa posedim të Licencës së Shfrytëzimit në bazë të nenit 79 par.3, 4 dhe 5 të Ligjit me nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale.

Kundër këtij aktvendimi paditësi, ka hapur konflikt administrativ me padi në gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave relevante, si në procesverbalin e seancës për shqyrtim kryesor të datës 14.10.2021, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, me aktgjykimin e ankimuar me ankesë e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se: Gjykata nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se paditësi ka paraqitur kërkesë për lëshimin e lejes për ndërtimin e objektit investiv: Depo e materialit ndërtimor – rrjeta metalike me etazhitet P në parcelën kadastrale P-71409067-00377-6, e regjistruar në certifikatën e njësisë kadastrale me numër 508/2017, në Zonën kadastrale në Poturovc, meqenëse u vlerësua se i njëjti i ka plotësuar kushtet për Lejen e Ndërtimit – Kushtet e Përgjithshme të specifikuar nga e paditura, ndërsa nga Raporti për Aktivitetet të Jashtëligjshëm me numër protokollit 10849 i datës 11.04.2018 në lokacionin Puturoc, komuna e Lipjanit, në prezencë të stafit të KPMM-së, SH.H.. Inspektori i Minierave – Xehetari, N.J., Inspektori i Minierave – Gjeologji E.M., Inspektori i Minierave – Elektrike N.S., vëllau i pronarit dhe V,S, i deklaruar në cilësi të përgjegjës të makinerisë në vend shfrytëzimi. Me rastin e inspektimit në vend ngjarje me datë 04.04.2018 është konstatuar ndërmarrja N.T.Sh. “Dino” Sh.P.K është duke kryer aktivitet minerar – shfrytëzim të lëndës minerale Ranor në mënyrë të jashtë ligjshme në lokacionin Poruroc të Lipjanit për arsye se nuk posedon Licencë Shfrytëzimi dhe se dokumentacioni i dëshmuar është jo i vlefshëm për veprimtarinë që ndërmarrja N.T.SH. “Dino” Sh.P.K kryen në terren për faktin se lënda minerale Ranor është duke u shfrytëzuar edhe jashtë koordinatave për të cilën ndërmarrja posedon vendim për Leje Ndërtimore, lënda minerale nuk është përdorur për Zonën Ekonomike nuk është e deponuar në ndonjë vend, nuk është përdorur për rrafshim të atij pllaci, mirëpo është komercializuar për qëllim të rrafshimit të terrenit në lokacione tjera për mbushje të pllaceve – oborreve të bizneseve në rajonin e Lipjanit dhe Ferizajt e që kjo veprimtari jashtë ligjshme bie në kundërshtim me Ligjin për Miniera dhe Minerale. Tutje Gjykata ka vërtetuar faktin se krahas inspektimit të raportit të përpiluar lidhur me aktivitetet e Jashtë Ligjshëm Minierave po ashtu KPMM nga shkeljet e gjetura në terren i ka ndërmarrë masat duke i lëshuar urdhëresë për ndërprerjen e aktivitetit të jashtë ligjshëm minerar dhe sekuestrimin e mjeteve të punës dhe mineraleve, për arsye se nuk e mbulon veprimtarinë që kryen edhe duke dal jashtë koordinatave të Zonës Ekonomike si dhe duke e komercializuar lëndën minerale Ranor pa u pajisur me licencë nga KPMM.

Lidhur me këtë dhe dispozitat e ligjit të lartcekur, gjykata vlerëson se dispozita ligjore janë aplikuar drejtë nga ana e të paditurës në procedurën administrative dhe se arsyetimi i vendimit është i bazuar në vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e paditësit dhe gjen se në këtë konflikt administrativ, nuk kanë ndikim në marrjen e një vendimi tjetër, sepse në bazë të provave të administruara, në vështirim të dispozitave të cekura ligjore, është vërtetuar se paditësi pa autorizim, ka ushtruar aktivitet të pa licencuar në kundërshtim me dispozitat e LMM-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë iu ka referuar nenit 79 par. 3, 4 dhe 5 të Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, me të cilin përcaktohet se: *“3. Nëse një Person shfrytëzon ose eksploaton minerale në mënyrë të paligjshme, KPMM do të shqiptojë këtij personi një gjobë që është e barabartë me trefishin e shumës së rentave minerare të cilat duhet të paguhen për mineralet e shfrytëzuara ose eksploatuara. KPMM do të krijojë një metodologji të arsyeshme për përlllogaritjen e sasisë së mineraleve të shfrytëzuara ose eksploatuara në mënyrë të paligjshme dhe do ta caktojë gjobën e lartpërmendur në përputhje me këtë metodologji. Ndërsa, me par.4. përcaktohet se: “Nëse një person zhvillon aktivitete të hulumtimit, shfrytëzimit ose aktivitete të veçanta pa poseduar Licencën ose Lejen e nevojshme, KPMM do të nxjerrë urdhër përmes të cilit i shqipton këtij Personi një gjobë në shumën prej pesëmijë (5000) Euro për secilin aktivitet të këtillë” . 5. “Gjobat monetare dhe mjetet juridike të përcaktuara në këtë nen janë kumulative (grumbulluese) dhe KPMM do të nxjerrë të gjitha urdhrat e nevojshme për shqiptimin ndaj Personit(ave) përkatës të të gjitha gjobave dhe mjeteve juridike të zbatueshme” . Po ashtu, edhe neni 4.1 të të njëjtit ligj përcakton se: “ Përveç siç është përcaktuar në paragrafin 2 te këtij neni, ky ligj zbatohet për të gjitha aktivitetet e hulumtimit, shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të resurseve minerale në Kosovë. Asnjë Person nuk mund të ushtrojë aktivitete të hulumtimit, shfrytëzimit dhe/ose*

përpunimit të resurseve minerale ose çfarëdo aktiviteti tjetër pa licencë ose leje të lëshuar nga KPMM në përputhje me këtë ligj". Andaj, përderisa kompania NTSH "Dino" Sh.P.K në aktivitetet e saj nga inspektimi i bërë është gjetur se ka vepruar në mënyrë jo të ligjshme dhe pa posedim të licencës duke e zhvilluar aktivitetin ilegal me lokacion sipas koordinatave Y=7502487; X=47091172; Z=609 me sasi të shfrytëzimit të mineraleve prej 12,987.87m³, në parcelën me numër 337-5, me këtë rast me të drejtë paditësit i ka aplikuar masën e ndëshkimit të gjobës në vlerën e shumës së përgjithshme prej 43,963.60 euro dhe atë në përputhje me dispozitat ligjore të nenin 79par.3,4 dhe 5 të Ligjit me nr.03/L-163 Për Miniera dhe Minerale.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate i vlerëson si të pa bazuara, nga se gjykata e shkallës së parë e ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së. Po ashtu gjykata ka vlerësuar drejtë se paditësi nga aktiviteti i tij ilegal nuk iu ka përmbajtur vendimit me numër të vrojtimit të lejes Nr.8-351-42331 i datës 15.03.2016 për leje ndërtimore nuk iu ka përmbajtur Kushteve të Ndërtimit – Kushtet e Përgjithshme të përcaktuara nga Departamenti për Prodhimin e Ujërave, Minierave dhe mineraleve në Lipjan, dhe me këtë rast ka gjetur se nga këto veprime të paditësit është shkelur dispozita ligjore nga neni 13, neni 30 paragrafi 1, neni 34 paragrafi 2 pika 2.2 i Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, ngase paditësi me asnjë fakt të vetëm nuk e ka bërë të besueshëm se ankesa e tij është e bazuar. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të padisë së paditësit dhe lënies në fuqi të vendimit të lart cekur, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mundë të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në vështrim të nenit 200 të LPK-së, i zbatueshëm si në vështrim të nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.1037/22, me datë 12.10.2023

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**